



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



REKK REGIONAL CENTRE
FOR ENERGY
POLICY RESEARCH



National
Association of
Regulatory
Utility
Commissioners

Obligimet universale të shërbimit në tregjet e liberalizuar

nga prof. V.Jankauskas

prezantuar në

**Punëtorinë e NARUC/ERRA mbi Rregullimin e
Kompanive të Shërbimeve Publike në Ekonomitë e
Tregut**

14-16 prill, 2008, Prishtinë



Center for
Energy and Natural Resources

- Kompanitë private kundër atyre publike
- Obligimet universale të shërbimit
- Direktivat e BE-së mbi obligimet e shërbimit publik
- Furnizuesi i opsionit të fundit
- Cilësia e shërbimit

Kompanitë publike kundrejt atyre private: synime të ndryshme

- synimi i kompanive private është kërkimi i fitimit
- kompanitë publike mund të kenë synime tjera të përcaktuara nga qeveria
- kompanitë publike mund të përkujdesen për mirëqenien e klientëve të tyre, pa keqpërdorur fuqinë e monopolit
- por kompanitë publike mund të përkujdesen për mirëqenien e politikanëve
- kompanitë publike mund të mbajnë punëtorë të panevojshëm, objekte të panevojshme, etj.

Nevoja për kërkesa universale të shërbimeve

- Kompanitë private, nëse janë të parregulluara, do të ndjekin fitime më të larta duke rritur tarifat dhe zvogëluar cilësinë, po ashtu mund të refuzojnë t'i shërbejnë klientët e largët dhe ata të cenueshëm
- Prandaj, jo vetëm çmimet por edhe cilësia duhet të rregullohen, si dhe, në mënyrë më të përgjithshme, duhet të vendosen kërkesat universale të shërbimeve

- Shërbim universal nënkupton një varg “adekuat” shërbimesh të një cilësie të përcaktuar në dispozicion për të gjithë përdoruesit pavarësisht nga lokacioni i tyre gjeografik dhe me çmim të arsyeshëm

- Qasje (fizike dhe gjeografike) dhe
- Çmime të kapshme;
- Zgjidhje (zgjidhjen më të gjerë të mundshme të shërbimeve, zgjidhje e plotë e metodave të pagesës);
- Transparencë dhe informim të plotë (informata të qarta për çmime, fatura dhe furnizues);
- Cilësi (besueshmëri dhe vazhdimësi të shërbimeve; opsione të pagesave; trajtim të ankesave; zgjidhje të kontesteve, monitorim të performancës);
- Siguri (shërbime të sigurta dhe të besueshme);
- Sigurim dhe besueshmëri (shërbime të pandërprera dhe të besueshme, përfshirë mbrojtje kundër shkyçjes);
- Paanësi (konkurrencë të drejtë dhe të vërtetë);

- “Vendet anëtare sigurohen se të gjithë klientët e ekonomive familjare dhe, nëse Vendet anëtare e konsiderojnë si të duhur, ndërmarrjet e vogla... gëzojnë shërbim universal, që do të thotë të drejtën për t’u furnizuar me energji elektrike të një sasive të caktuar në çmime të arsyeshme, lehtë dhe qartë të krahasueshme dhe transparente.”

- Vendet anëtare mund të imponojnë në ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e energjisë, në interes të përgjithshëm ekonomik, obligime të shërbimit publik të cilat mund të lidhen me
 - sigurimin, përfshirë sigurimin e furnizimit
 - rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimeve
 - mbrojtjen mjedisore, përfshirë efikasitetin e energjisë dhe mbrojtjen e klimës
 - » Direktiva 2003/54/EC, neni 3

- definoohen qartë
- jenë transparente
- jenë jodiskriminuese
- jenë të verifikueshme
- garantojnë barazi të qasjes për kompanitë energjetike të BE-së për konsumatorët vendorë
 - Direktiva 2003/54/EC, neni 3

- Kërkojnë nga Vendet anëtare ndërmarrjen e masave të duhura
 - për të mbrojtur klientët e cenueshëm (përfshirë ndihmën e tyre për t'iu shmangur shkyçjes)
 - për t'i mbrojtur klientët përfundimtarë në vende të largëta
 - për të siguruar nivele të larta të mbrojtjes së konsumatorëve, veçanërisht për sa i përket transparencës lidhur me termet dhe kushtet kontraktuese, informatat e përgjithshme dhe mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve
- Vendet anëtare mund të caktojnë furnizues të opsionit të fundit për të siguruar ofrimin e shërbimit të universal
 - Direktiva 2003/54/EC, neni 3

- Shtetet anëtare, pas zbatimit të kësaj, direktive, do të informojnë Komisionin mbi të gjitha masat e adoptuara për përmbushjen e obligimeve të shërbimit universal dhe shërbimit publik, përfshirë
 - mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbrojtjes mjedisore,
 - dhe ndikimin e tyre të mundshëm në konkurrencën vendore dhe ndërkombëtare,
 - faktin nëse masat e tilla kërkojnë, apo jo, heqje nga kjo direktivë.
- Ato duhet të informojnë Komisionin çdo dy vite mbi ndonjë ndryshim në masa të tilla,
 - nëse ato kërkojnë, apo jo, heqje nga kjo Direktivë.
 - » Direktiva 2003/54/EC, neni 3

- Sigurimi i shërbimit universal për të gjithë qytetarët
 - me furnizim të sigurt
- Në një mjedis sa më konkurrues
 - me hapësirë loje për të gjithë furnizuesit

- Sipas të dyja direktivave, të gjithë konsumatorët (përfshirë ata rezidencialë) nga 1 korriku 2007 kanë të drejtë që të zgjedhin furnizuesin
- A do të thotë kjo se 100% e hapjes së tregut të pakicës shënon fundin e tarifave të rregulluara?
- ERGEG zbuloi se (që nga qershori 2007) 17 nga 27 vendet anëtare të BE-së (në lidhje me energjinë) dhe 9 shtete anëtare të BE-së (në lidhje me gazin) me tregje pjesërisht apo plotësisht të hapura, kishin rregullim të çmimit të përdoruesit të fundit në së paku një segment të tregut të hapur

- Rregullimi i çmimit të fundit në tregjet e energjisë dhe të gazit çrregullon funksionimin e tregut
- Ndonëse në teori, tregu është i hapur, në praktikë mund të jetë akoma vetëm një furnizues dhe të ketë mungesë konsekuente të zgjidhjes për konsumatorët
- ERGEG bën thirrje për të gjitha shtetet që janë në periudhë kalimtare që të publikojnë (deri më 1 korrik 2008) një plan individual drejt tregjeve konkurruese për të larguar çmimet e rregulluara

- Direktivat BE-së madje edhe pas periudhës kalimtare lejojnë largimin e çmimeve të rregulluara të energjisë së përdoruesit të fundit për të mbrojtur konsumatorë të caktuar të cenueshëm dhe të largët, nëse është e nevojshme
- Megjithatë, mbrojtja e “konsumatorëve të cenueshëm” nuk duhet të ngatërrohet me mirëmbajtjen e çmimeve të rregulluara të energjisë për të gjithë (apo kategori të caktuara të) konsumatorët
- Nëse nuk ka konkurrencë në mes të furnizuesve apo nëse disa furnizues dominojnë në treg çmimet për konsumatorët e fundit mund të rregullohen (ndoshta përkohësisht)

- Furnizuesi i opsionit të fundit (FOF) është vegël që mbrohet konsumatorët që mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë energji me kushte të arsyeshme
- Furnizuesi i Opsionit të Fundit është i obliguar që të ofrojë energji për konsumatorët e fundit në situata emergjente sipas legjislacionit kombëtar kur furnizuesi i zgjedhur nuk shërben apo nuk mund të shërbejë

- Nga furnizimet e *Qasjes Amerikane* SLR:
 - ▶ Konsumatorët kaptivë të para se të bëhen më të zotësi juridike
 - ▶ Konsumatorët e cenueshëm të cilët furnizuesit nuk dëshirojnë t'i shërbejnë pa siguri të kompensimit të rregulluar
 - ▶ Konsumatorët e largët që nuk janë kosto efektive për të shërbyer pa subvencion
 - ▶ Konsumatorët e parazgjedhur – Konsumatorët më të drejtë të cilët kurrë nuk zgjedhin
 - ▶ Konsumatorët e braktisur – Konsumatorët me të drejtë të cilët zgjedhin, por diçka ndodhë me furnizuesit e tyre

- FOF nuk është obliguese
- Është mekanizëm me të cilin përmbushet shërbimi universal
- Shërbimi universal zbatohet vis-à-vis klientëve të vegjël të energjisë
- Masat mbrojtëse të FOF nuk mund të pengojnë zhvillimin e tregjeve konkurrues pa kufij
- Kompensimi dhe të drejtat duhet të vendosen në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente

- FOF zbatohet kur furnizuesi ka braktisur tregun (dalje e paplanifikuar apo e planifikuar, heqje e licencës)
- FOF zgjidhet përmes ankandit para daljes
- Rregullatori themelon një Komision të ankandit
- Rregullatori mban listën e FOF-ve potencialë, të aranzhuar sipas fushës së shërbimit dhe kategorisë (rezidencial, komercial të vegjë;, klientë të mëdhenj)
- Ofertat vlerësohen sipas propozimit të çmimit, nëse nuk ka oferta, rregullatori cakton

- cilësia e rregullimit të furnizimit është duke u bërë një çështje shumë e rëndësishme për rregullatorët
- CEER në vitin 2006 ka publikuar një studim të cilësisë së furnizimit në Shtetet anëtare të BE-së
- një studim i ngjashëm së fundi është kryer nga ERRRA

- *Cilësia komerciale* përfshin çështjet si koha e lidhjes së re (para se të hyjë në fuqi kontrata e furnizimit), si dhe leximi i njehësorve, faturimi, trajtimi i pyetjeve dhe ankesave të konsumatorëve, shpejtësia dhe saktësia në kontrollimin e voltazhit të furnizimit dhe mbajtja e takimeve (gjatë vlefshmërisë së kontratës)
- *Vazhdimësia e furnizimit* në lidhje me ndërhyrjen e shërbimit për konsumatorët e lidhur me rrjetin e shpërndarjes; me fjalë tjera, ngjarjet gjatë së cilave voltazhi në lidhjen e konsumatorit bie në zero
- *Cilësia e voltazhit*, përfshirë një varg devijimesh të mundshme të karakteristikave të voltazhit nga vlerat e dëshiruara

- instrumentet kryesore rregullative janë
 - standardet e performancës
 - kushtet e licencës
- standardet e performancës
 - standardet e garantuara – duhet të përmbushen nivelet e shërbimit, përndryshe ndëshkohen
 - standardet e përgjithshme – konsumatorët mund të presin nivele të parapërcaktuara të shërbimit – nuk ka ndëshkime

- Në tregjet e liberalizuar të energjisë konsumatorëve të cenueshëm (klientët rezidencial dhe komercial të vegjël) duhet t'u garantohet gëzimi i shërbimit universal
- Direktiva 2003/54/EC ka përkufizuar një varg OShP-ve
- për rregullatorët është shumë me rëndësi që OShP-të të jenë qartë të definuar, transparentë, jodiskriminues dhe të mos e çrregullojnë tregun

JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN TUAJ!

REKK është themeluar në Universitetin Corvinus në Budapest në dhjetor të vitit, 2003. Misioni i REKK është që të kontribuohet në krijimin e tregjeve të energjisë dhe themelimin e rregullimit efikas përmes zbatimit të hulumtimit të aplikuar, trajnimeve dhe aktiviteteve cilësore konsulente për të gjithë personat dhe organizatat e interesuara që janë aktive në këtë fushë.

Ne mendojmë se përvojat që i kanë fituar Hungaria dhe vendet tjera të Evropës qendrore dhe lindore përmes ristrukturimit dhe rirregullimit të tregjeve të tyre të energjisë janë të vlefshme dhe relevante për të gjitha ekonomitë në tranzicion. Kjo është arsyeja pse qendra synon që të vendos theks të veçantë në hulumtimin dhe shpërndarjen e përvojës rajonale dhe synon të bëhet qendër rajonale e hulumtimit dhe trajnimit.

Adresa:

Regionális Energiagazdasági Kutatóközpont (REKK)

1093 Budapest, Fővám tér 8.

Tel: +(36 1) 482 8971, Fax: +(36 1) 215 8894

Web: <http://rekk.bkae.hu>, E-mail: vjankauskas@uni-corvinus.hu